



**GRUAJA NGA
KËNDVËSHTRIMI I AJETIT 35
TË SURES "EL-AH'ZAB"**



**ISLAMI KËRKON TË ECË
PËRPARA ME PARIMET E TIJ
TË PATUNDSHME**



**BESIMI ËSHTË GJALLËRIM
PËR JETËN**

Viti 17 - Nr. 2 (192),
Shkurt, 2019


Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

*E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative*

Njerëzimi nuk do të gjejë si Islami; Kur'ani dhe Tradita e Hz. Muhammedit (a.s.)

në trajtimin e femrës; si bijë, si nënë, si bashkëshorte,
si motër, si edukatore të nderuar e të respektuar!



Universiteti më i vjetër në botë
Universiteti Kajravan në Fes, Marok
Themeluar në vitin 859 nga Fatime El-Fihrije



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

GRUAJA NGA KËNDVËSHTRIMI I AJETIT 35 TË SURES "EL-AH'ZAB"

si pasojë e prishjes dhe imoralitetit, shthurrjes dhe çlirimit nga përgjegjësitë në jetë!

Përtej të gjitha leximeve dhe interpretimeve, njerëzimi nuk do të gjejë si Islami; Kur'ani dhe Tradita e Hz. Muhammedit (a.s.) në trajtimin e femrës; si bijë, si nënë, si bashkëshorte, si motër, si edukatore të nderuar e të respektuar!

Shihni se si trajtohet femra në shoqëritë e sotme materialiste dhe se si ky model decadent, po tentohet të katapultohet dhunshëm edhe në realitetet shqiptare, nëpërmjet përpjekjeve të ndryshme që bëhen drejt "çlirimit të femrës" në shoqëritë e hapura, "lirisë absolute" në shoqëritë moderne, e të ngjashme!? Të gjitha këto përpjekje të dëmshme dhe lajkatare, duan të shkatërrojnë tabanin e shëndoshë, që bazohet mbi edukimin fetar të vajzave, motrave, nënave e grave!

"Shkurt mund të thuhet se Kur'ani me principet udhërrëfyese të vetat, femnen e mashkullin e ka bamë qi të bashkohen në fushën e drejtësisë e të barazimit me të drejta të nja. Dmth, mashkullin e ka zbritë nga pozita dhunuese e tiranike dhe femnen e ka naltue nga pozita e poshtimit"³, siç shkruhet edhe në shtypin tonë islam të vitit të largët 1930!

Por, ajo që është më e rëndësishme për t'u përmendur në këto kontekste, është se cila është detyra e imamëve, vaizeve, thirrësve islamë në drejtim të thirrjes me urtësi e largpamësi, larg tendencave të ekstremizmit dhe leximit të cungët të teksteve dhe fetvave, që shpesh kanë ndikuar në etiketimin e fesë islame me çfarë nuk e meriton dhe me çfarë nuk është në realitet!

Ku jemi në drejtim të përhapjes së mësimave qytetëruese të fesë tonë dhe edukimit fetar të brezit të ri, në realitetet e mungesës së lëndës së edukatës fetare në shkollat e vendit tonë, si dhe përtej demagogjisë së premtimeve elektorale dhe tendencave të përhapjes së ateizmit dhe afetarizmit, edhe nëpërmjet tribunave politike dhe ithtarëve të rinj të frymërave të reja që

e duan shoqërinë njerëzore larg besimit dhe fesë, larg disiplinës së besimit dhe përkushtimit ndaj Fjalës së pandryshuar të Zotit; Kur'anit Famëllartë, si garanci e padiskutueshme dhe krejtësisht e mundshme për ndreqjen e asaj që dekada e shekuj kanë prishur në jetën e njeriut!

TË DASHUR TË PRANISHËM,

Imam Shihabuddin El-Alusi (v. 1270 h.), përmend një detaj me rëndësi në shpjegimin e ajetit të lartpërmendur, thotë: ["muslimanët dhe muslimanet", dmth, ata që kanë hyrë në botën e paqes, të nënshtruarit ndaj ligjit të All-llahut të Madhëruar, ata që ia kanë dorëzuar jetën e tyre All-llahut të Madhëruar, burra a gra qofshin].⁴

Këtë duhet të synojmë me krejt përpjekjet tona në proceset e edukimit të

Përtej të gjitha leximeve dhe interpretimeve, njerëzimi nuk do të gjejë si Islami; Kur'ani dhe Tradita e Hz. Muhammedit (a.s.) në trajtimin e femrës; si bijë, si nënë, si bashkëshorte, si motër, si edukatore të nderuar e të respektuar!

brezit të ri, nëpërmjet vaseve, hytbeve, takime sporadike, ligjëratave, tribunave fetare, në medrese, në mejtepe, në gazeta, në revista, nëpërmjet rrjeteve sociale, emisioneve radiofonike, atyre televizive dhe me krejt mundësitë legjitime që na janë dhënë në këtë kohë! Nuk duhet të ndalemi për asnjë moment dhe aq më tepër të stepemi përballë propagandave të mbështetura nga faktorë të huaj dhe axhenda të përgatitura kushedi se ku, që vijnë të gatshme dhe gjejnë terren të përshtatshëm për vegjetimin e tyre tek individë të dobët të kësaj shoqërie dhe çdo shoqërie në botë!

4. Imam Shihabuddin El-Alusi, Rruhul-Meani, botimi i 4-t, Liban, 2014, vëll. 11, f. 201.

Duke iu rikthyer ajetit të 35 të sures El-Ah'zab, në librat e tefsirit gjejmë se: "All-llahu i Madhëruar, nëpërmjet këtij ajeti deshti të na vërtetojë se gruaja është njësoj si burri në obligime dhe në vlerësim; ajo është e ngarkuar me Islam, me besim, me adhurim, me durim, me përlulje, me mirëbërje, me agjërim, me ruajtje të nderit e me përmendjen e shumtë të All-llahut, njësoj si burri. Kjo vërteton edhe një herë ajetin kur'anor: "Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre"⁵... Madje femra besimtare ka një pozitë të lartë tek All-llahu, më të lartë se ajo e njëmijë burrave të shturrur! Gruaja e bindur është e afërt me All-llahun, ndërsa burri i shturrur, larg Tij! Prandaj, mashkulli dhe femra, burrat dhe gratë, të rinjtë dhe të rejtat, vajzat dhe djemtë, të gjithë janë të barabartë tek All-llahu, asnjëri nuk qëndron më afër, përveç se nëpërmjet adhurimit ndaj Tij!"⁶

Për fund të këtij vështrimi të shpejtë, iu ktheva librit të famshëm të Hoxhës tonë Vehbi S. Gavoçi, "Gruaja muslimane". Në botimin e tetë të tij, gjeta edhe këtë shënim thelbësor: "Islami e ktheu gruan në natyrën e saj të origjinës, në të cilën e krijoi All-llahu. Islami e ktheu gruan në udhëzimin, që All-llahu i Madhëruar ia zbriti njeriut të parë, Ademit (a.s.), për të mirën e njerëzimit! Sepse Islami është ide dhe sistem, Islami është e vërtetë dhe udhëzim dhe, nuk është lidhur ndonjëherë ideja e saktë, duke qenë ide e saktë, me kohën, sepse ajo qëndron mbi kohën! As është lidhur ndonjëherë e vërteta, duke qenë e vërtetë, me kohën, sepse ajo qëndron mbi kohën!

A nuk e ke parë të vërtetën, besën, turpin, dashamirësinë ndaj njerëzve, solidaritetin në të mirë, bindjen ndaj udhëheqësit në të mirë, etj.; të gjitha këto janë çështje të vjetra dhe edukatë e kaluar, porse ato sundojnë çdo kohë dhe qëndrojnë mbi çdo kohë, sepse koha është enë dhe shfaqje, ndërsa e vërteta – Islami është e vërteta – ajo është origjina dhe thelbi!"⁷

(Kumtesë e mbajtur në Konferencën e 8-të vjetore të imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës, më 23 shkurt 2019)

5. Kur'ani, En-Nahl: 97.

6. Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi, Tefsirun-Nabulsi, botimi i parë, Aman, 2016, vëll. 7, f. 294.
7. Vehbi Sulejman Gavoçi, El-Mer'etul-muslima, botimi i 8-të, Damask, 1999, f. 31-32.

"GJYNAHET E MËDHA, PRAG HUMNERASH PËR RACËN NJERËZORE!"

"VEPRUESI I FAJDEVE KA MALLKIMIN E ALL-LLAHUT NË KËTË JETË!"

"Sa e sa po dëgjojmë për njerëz që japin borxhe me fajde, që japin borxhe me shtesa marramendëse..!? Njerëz që po lënë shtëpitë e tyre. Njerëz që po arrijnë deri në ekstremitete për shkak të këtij krimi të madh, që quhet: fajde!

Vepruesi i fajdeve ka mallkimin e All-llahut në këtë botë dhe poshtërim në ditën e gjykimit! Po le të ketë sa mali i Taraboshit me miliona dhe miliarda se, pasha All-llahun as sa një fije floku nuk do të ketë dobi prej tyre, pasi të jetë larguar nga kjo botë! Përpos faktit se, nuk ka as sa një fije floku bereqet ajo pasuri, që është vendosur nga munda dhe djersa e të tjerëve! Ajo është haram!"

Kjo ishte një pjesë e mesazhit, me të cilin, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua komunitetit, nga minberi i xhamisë së "Dy Vajzave", teksa po fliste për shfaqjen e gjynaheve të mëdha në shoqëri dhe domosdoshmërinë e ndryshimit, bazuar në tekstet e fesë!

Myftiu theksoi se, shirku me krejt format e tij, magjia në krejt format e saj, vrasja e të pafajshmit, fajdet, ngrënia e pasurisë dhe hakut të jetimit, dezertimi dhe ikja nga përgjegjësitë e jetës dhe akuzimi i nderit të grave të moralshme; janë krime dhe gjynahe të mëdha, prej të cilave duhet distancuar!

Ai theksoi gjithashtu se, lista e këtyre krimeve, që e shkatërrojnë fenë dhe jetën arrin deri në 70 dhe se, Islami është garanci për shërimin e shoqërisë dhe individit nga çdo lëngatë shkatërruese!

"GJYNAHET E MËDHA, PRAG HUMNERASH PËR RACËN NJERËZORE!"

"Këto 70 e ca gjynahe të mëdha janë prag humnerash për racën njerëzore. Edhe një hap dhe njeriu bie në humnerë dhe humbet këtë botë, këtë jetë dhe jetën e përtejme!

Këto janë thirrje për secilin prej nesh dhe për shoqërinë tonë, për t'u distancuar prej këtyre veprave, sepse veprimi i tyre e prish racën njerëzore! Se veprimi i tyre e prish jetën mbi tokë! Se veprimi i tyre sjell mallkim dhe largim nga mëshira e All-llahut të Madhëruar!"

Me këto fjalë e ka nisur këshillë e kësaj jave nga minberi i xhamisë së "Dy Vajzave",

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, të xhumanë e 8 shkurtit 2019.

Myftiu u ndal edhe tek gjynahu i madh i lënies së adhurimeve që përbëjnë shtyllat kryesore të Islamit, ku ndër të tjera përmendi: "Shqiptarët e dijnë shumë mirë se çfarë pasojash ka mosdhënia e zekatit! ... Prishja e ditës së Ramazanit pa justifikim e pa tolerim, siç shumë njerëz thonë: Musliman jam! Me u falë nuk falen, zekat nuk japin, në haxh nuk shkojnë, alkoolin e konsumojnë, ndonjë gjë tjetër e veprojnë dhe kur vjen dita e Ramazanit, thotë: Jo, unë nuk agjëroj, po musliman jam! Çfarë muslimani, çfarë muslimani?!"

Shirku me krejt format e tij, magjia në krejt format e saj, vrasja e të pafajshmit, fajdet, ngrënia e pasurisë dhe hakut të jetimit, dezertimi dhe ikja nga përgjegjësitë e jetës dhe akuzimi i nderit të grave të moralshme; janë krime dhe gjynahe të mëdha, prej të cilave duhet distancuar!

Në hytben e kësaj xhumaje, Myftiu foli edhe për krimin e madh të vjedhjes së vakëfit dhe xhamive, duke theksuar se ngritja e zërit kundër këtij krimi të shëmtuar është detyrim moral e kombëtar, përtej thirrjes së besimit!

Gjithashtu, Myftiu iu referua edhe reklamimit në masë të imoralitetit, sidomos në media, heqjes së perdes së turpits dhe përpjekjeve për të legjitimuar çdo ves e prapësi, si të drejtë e çështje që lidhet me lirinë e individit dhe të shoqërisë.

Kjo është hytbeja e dytë e një serie ligjëratash, që Myftiu po mban, duke tërhequr vëmendjen e shoqërisë për t'u distancuar nga gjynahet e mëdha dhe veprat, që e shkatërrojnë jetën e njeriut dhe harmoninë e të jetuarit në paqe me Zotin, botën e tjetrin.

Hytbeja e xhumasë, mbajtur nga Imam Muhamed Sytari, xhamia e "Dy Vajzave", 1 dhe 8 shkurt 2019

1. Kur'ani, El-Ah'zab: 35.
2. Imam Ebu Mensur El-Maturidi, Te'vilatu Ehli-Sunne, botimi i parë, Liban, 2005, vëll. 8, f. 384-385.

3. Artikulli me temë: "Grueja duhet të respektojë Kur'anin më tepër se mashkulli", në revistën "Zani i Naltë", vjeti VI, Dhilixhe 1348 – Majë 1930, nr. 6, f. 1027.

QOFSH GJITHMONË PRIJËS I PAQES DHE I HUMANIZMIT!

FESTA E KUVAJTIT, MYFTIU I SHKODRËS URON AMBASADORIN AL-JASSIM

Me rastin e përkujtimit të datave 57 vjetorit të Pavarësisë dhe 27 vjetorit të Ditës së Çlirimit të Shtetit të Kuvajtit, mbrëmjen e së enjtes, më 21 shkurt 2019, ambasada e Kuvajtit në Shqipëri ka organizuar një pritje të posaçme.

Me këtë rast, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, ka uruar ambasadorin e Kuvajtit në Shqipëri, z. Fajez Mishari Al-Jassim (Fajiz Mishari El-Xhasim), që marrëdhëniet vëllazërore në mes Shqipërisë dhe Kuvajtit të forcohen përherë e më shumë, në shërbim të forcimit të shpirtit të vëllazërisë së dobishme.

Imam Sytari falënderoi kontributin e madh që ka dhënë dhe vazhdon të japë Shteti i Kuvajtit për gjallërimin e vlerave dhe trashëgimisë islame në vendin tonë, nëpërmjet përkrahjes së projekteve të ndryshme në këtë drejtim, si ndërtim xhamishë, qendra kulturore, shtëpi dhe mbështetje financiare për jetimet etj.

Duhet theksuar se në historikun e themelimit si shtet i pavarur, Kuvajti celebron dy data të rëndësishme, atë të shkëputjes nga Britania e Madhe në 1961, si dhe çlirimin nga Iraku.

Shteti i Kuvajtit ka investuar disa projekte zhvillimore me një vlerë totale prej 10 milionë euro. Këto projekte janë një tregues i qartë të bashkëpunimit mes dy vendeve dhe ndihmës bujare që Shteti i Kuvajti i ka dhënë Shqipërisë.



**Shejkh Sabah El-Ahmad El-Xhabir Es-Sabah
Princ i Shtetit të Kuvajtit**



101 VJET NGA NDËRRIMI JETË I SULTAN ABDULHAMID HANIT



Më 10 shkurt 2019 është dita e 101 vjetorit të ndërrimit jetë të Prijësit të besimtarëve, njërit prej halifëve më të fortë të Islamit, njërit prej politikanëve dhe ekonomistëve më mendjemprehtë në epokën bashkëkohore, Sulltan Abdulhamid Hani, All-llahu e mëshiroftë, e lartësoftë gradën e tij dhe e shpërbleftë për mbarë ymetin islam!

Laikët u përpoqën ta mbulojnë dhe ta errësojnë biografinë e tij, mbështetur edhe nga orientalistët dhe lëvizjet nacionaliste, duke e cilësuar si gjakatar dhe të padrejtë. Fshehën dokumentet që nxjerrin në pah të vërtetat! Por, një ditë e vërteta do të dalë në pah, duke triumfuar!

Akoma sot, përkujtimi i tij u prish rehatinë, teksa frikësohen se mos ringjallet historia e tij!

Rahmet pastë!

*(Me përshtatje nga gjuha arabe:
Muhammed B. Sytari,
nga faqja zyrtare
e studiuesit skrupuloz:
Dr. Murhaf Sekka)*

MË SHUMË SE NJË KUJTIM, PËR TË MIRIN HOXHË..!

Ishte data 19 shkurt 2013, një ditë e cila solli me vete lajmin e kalimit në jetën e përhershme, të Hoxhës së palodhur, edukatorit me sjellje e vepra, njeriut të urtë, shkollarit të thelluar, detit të diturive, përpapësit të paqes e mirësisë, si flladet pranverore që gjallëri dhurojnë, Zotërisë tonë, Shejkh Vehbi Sulejman Gavoçi!

Sot bëhen gjashtë vite, por zemra e di shumë mirë se, dashnia e Hoxhës është gdhendur në brendësinë e saj, aq sa me çdo rrahje, ajo vazhdon të pulsojë nderim e respekt, përzier me mall e ndjenjë mungese për Dritën e shfaqjes së Zotërisë së tij, si diell që ndriçon nga lartësitë e dhuruara nga Krijuesi i gjithësisë!

Sot, librat, kujtimet, letrat e këshillat e regjistruara, vazhdojnë të flasin

të gdhendur në vetëdije, mbi të cilin ndërtohet jeta, me krejt detajet e saj!

Dashnia dhe malli për fytyrën e tij plot nur, zërin me ëmbëlsinë e timberit të mekur, lëvizjet e paqta, buzëqeshjet plot dritë, reagimet plot dridhje zemre për hallet e njerëzimit, përgjigjet e urta për pyetjet e shumta, modestinë e pashembullt, vrullin e Thirrjes e përvëlmin e zemrës për këtë fé të madhnueshme islame, për të cilën jetoi dhe, për shërbimin e së cilës na mori besën!

Hoxha, rahmet pastë, ishte dhe mbeti kufri i ndarjes nga një kohë e një botë, drejt një kohe e një bote, universi i së cilës sillet rreth një orbite në cakun e të shenjtës, thelbi i së cilës dëshmon në vetvete thirrjen ndërtuese: “Zoti im, Ti je qëllimi im! Pëlqimi Yt, është kërkesa ime!”.



me ëmbëlsinë e shfaqjes së tij, si një sadeka rrjedhëse, shpërblimet e së cilës vazhdojnë t'i shkojnë, edhe si dëshmi e përljes para bekimit të madh, me të cilin, All-llahu i Madhëruar na zbukuroi jetën, ditën e takimit tonë të parë dhe qëndrimin në besë..!

Sa herë e kujtoj Hoxhën, më vjen ndër mend Hafiz Musa Hoxha (All-llahu e shpërbleftë me mirësitë e Tij), i cili, ndonëse në moshë të thyer, kur kujtonte Hoxhën e tij, Haxhi Muhamed Bekteshin, mekej dhe i shkonin lotët nga malli.

I habitur nga pamja e tij, pyesja me vete se, çfarë ishte kjo lidhje, që e bënte Hoxhën mjekërbardhë, në moshë të thyer e në kufijtë e pleqërisë së mbrame, të qante për Hoxhën e tij rahmetli, që ishte ndarë nga kjo botë që më shumë se gjysëm shekulli më parë? Pa dyshim dashnia e sinqertë dhe gjurma e shembullit

Me këtë u edukua, për të jetuar me dinjitet, për të shërbyer me korrektësi, për të mos bërë kompromise me fenë, as për ta përdorur atë për qëllime të kësaj bote kalimtare! Për t'i dashur krijesat e Zotit për Krijuesin e tyre, jo për forma e interesa, për ta thënë të vërtetën me mirësi e guxim, për të mos pranuar poshtërimin e fesë, as nënçmimin e saj! Për ta përhapur këtë dritë të pashuar islame, sa të jemi, deri në frymën e fundit, duke mos pritur falënderime, as mirënjohje nga askush në botë, duke shpresuar pranimin tek Mëshirëbërësi dhe takimin tek kroi i Resulull-llahut (a.s.) në ditën e gjykimit!

Gjashtë vjet, si një perde ndarëse, që kurrë s'e ndau zemrën nga përmendja e mirësisë së Zotit; shfaqjen e Zotnisë Tande në jetën e saj!

Si djallë, Muhamedi...



Arben Halluni, teolog

VËLLAZËRI DHE JO RACIZËM!

historinë e të drejtave të njeriut, i pari konfirmim për nderimin e njeriut dhe e para iniciativë për të drejtën e barazisë midis njerëzve, pa marrë parasysh racën, gjininë, kombin, gjuhën, fenë etj.

Përpara Islamit njerëzit kanë qenë të ndarë në sundimtarë tiranë dhe në të sunduar si kafshët. Jo vetëm kaq por historia ka përmendur se Perandoria Romake ka qenë e ndarë në dy bashkësi: Të lirët, të cilët kanë qenë vetë romakët dhe robërit e tyre. Kështu ka vepruar edhe Perandoria Bizantine etj.

Me ardhjen e dritës së pushuar të Islamit u shpall vendimi i prerë rreth problemit të diskriminimit racor midis njerëzve mbi bazën e gjinisë, ngjyrës, prejardhjes etj. Një hadith i profetit Muhammed (a.s), thotë: “Njerëzit janë të gjithë bijtë e Ademit dhe Ademi është prej dheut”. (transmeton Ebu Davudi dhe Tirmidhiu)

Gjithashtu Islami ndaloj ndarjen raciste mbi bazën e pasurisë, pozitës e të forcës, sepse të gjitha këto janë dhunti të përkohshme, sepse janë nga materia e botës dhe bota është drejt shuarjes. Njerëzit mund të dallohen vetëm mbi bazën e vlerave të përhershme dhe koncepteve të Ahiretit mbi të cilat qëndron fati i të gjithë njerëzve. “Ditën kur nuk bën dobi as malli, as fëmijët. (bën dobi) Vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të pastër”. (En-Nahl: 88-89)

Të gjithë njerëzit sado që të kenë dallime në rrizqet dhe në potencialet e tyre materiale janë të barabartë si dhëmbët e krehrit. Kjo ka vlejtur për Hz. Omerin kurejshit, për Bilalin El-Habeshi, për Suhejbën romak, për Selmanin persian, por edhe për Hz. Muhammed Musatafan (a.s), ku për këtë të fundit, një ajet kur'anor thotë: “Thuaj: Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju”. (El-Fussilet, 6).

Devocioni tek Allahu (xh.sh) është çdo gjë që mund të marrë nga robërit e Tij. Sado që të shtohet pasuria nuk ka peshë të mizani (peshorja) e Allahut Fuqiptotë, sado që forca të jetë e madhe nuk ndikon asgjë në vendimin e Krijuesit të universit dhe sado që një gjini të sundojë mbi një gjini tjetër nuk do të merret në konsideratë nga Zoti Madhniplotë. Ajo që do të merret parasysh nga Allahu (xh.sh) është devotshmëria, e cila është themel i Ditës së Llogarisë. Pikërisht për këtë thuhet në Kur'an: “S'ka dyshim se Allahu është me ata që janë të devotshëm (që ruhen prej të këqijave) dhe me ata që janë bamirës”. (En-Nahl: 128) Ky ajet kur'anor ka qenë proklamata e parë në

barazisë së drejtë nën hijen e thirrjes islame. Shumë njerëz kanë hyrë në Islam grupe-grupe, të zinj e të bardhë, të verdhë dhe të kuq, për shkak se në Islam kanë gjetur thirrjen e liritimit nga robëria, thirrjen e shkatërrimit të shtresave zotëruese dhe thirrjen e heqjes së dallimeve individuale. Profeti Muhammed (a.s) ka thënë në një citat të tij profetik: “...Kush cenon (me ndarje raciste) një mysliman ai do të ketë mallkimin e Allahut, melekëve dhe të gjithë njerëzve”. (transmeton Muslimi)

“O JU NJERËZ:
NË TË VËRTETË ZOTI JUJ
ËSHTË NJË, BABAI JUJ
ËSHTË NJË, NUK KA DALLIM
ARABI NDAJ JOARABIT,
AS JOARABI NDAJ ARABIT,
AS I KUQI NDAJ TË ZIUT,
E AS I ZIU NDAJ TË KUQIT
VETËM ME DEVOTSHMËRI,
S'KA DYSHIM
SE MË I NDERUARI
TEK ALLAHU ËSHTË AI
QË KA FRIKËN E TIJ”

Dëgjojmë e shohim se disa udhëheqës në disa vende pretendojnë se janë gjoja mburoja e lirisë dhe apeluesit e barazisë, në një kohë që dëgjojmë e shohim lajme të persekutimit e të diskriminimit racist që ushtrojnë po këta pretendues mbi popujt që kanë ngjyrë tjetër, racë tjetër etj. Fakte për këtë ka shumë dhe dihen. Më e çuditshme është se kemi dëgjuar më përpara për njoftime të shkruara në portat e vende publike në disa shtete: “Ndalohet hyrja e zezakëve dhe e qenve”.

P.sh në kontinentin afrikan ekzistojnë pakica të bardhish në disa zona. Për interes të tyre kanë formuar

qeveri raciste që urdhërojnë agresion në emër të ngjyrës së bardhë mbi shtresa që nuk përputhen me iluzionet tyre. Sa herë dëgjojmë që këtyre shtresave të thjeshta u ndalohen resurset e begatitë e vendeve të tyre, u ndalohet të bëjnë një jetë normale, u ndalohen padrejtësisht mësimi, shërimi etj. Jo vetëm kaq, por atyre u imponohet varfëria e skamja në mënyrë që të qëndrojnë në nivelin e të qenarit robër në rezidencat e të bardhit kolonialist.

Shkaku substancial që fshihet mbrapa kësaj ndarje raciste është se njeriu i bardhë jeton në jetën bashkëkohore me dy ndërgjegje: Ndërgjegjja e të civilizuarit midis popullit të tij të bardhë dhe ndërgjegjja e kolonizatorit që mbijeton me viktimat zezakë. S'ka dyshim se ky lloj diskriminimi racist është i kundërt me atë që ka sjellë feja. Besimi i ka dhënë njeriut nderin me anë të cilit jeton ballë-hapur. Islami është fe që i ka mësuar njeriut se universi është krijuar për t'i shërbyer atij. Islami është fe që i ka vendosur interesat ekonomike nën interesin e njeriut, mirëpo ajo çka po ndodh realisht është se diskriminimi racist ka vendosur ekonominë mbi njeriun dhe më keq është bërë zotëria e njeriut nënshtrues.

Detyra jonë ndaj këtyre popujve të shtypur, pavarësisht doktrinës fetare, racës, ngjyrës etj, është e njëjta detyrë që kemi ndaj fesë sonë, për të cilën jemi të obliguar të ngremë lart flamurin e saj dhe të shpallim sa më shumë fjalën e saj të vërtetë dhe paqësore.

Shumë shtete të Afrikës kanë braktisur kolonializmin që i la për dekada në prapambetje, analfabetizëm e varfëri. Kolonializmi dhe varfëria janë njëlloj, secila prej tyre është xhelat i nderit të njeriut. Në kohën që tregtarët dhe thirrësit myslimanë mbartën mësimet tolerante të Islamit, popujt e etur për besim u ngritën dhe përqaftuan me devotshmëri parimet e fesë së Zotit, i Cili dhuroi lirinë e vëllazërinë e pa krahassuar. “...Ndërsa e tërë krenaria i takon Allahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve”. (El-Munafikun: 8)

Ndërsa, nga i Dërguari i Allahut mësojmë se ka thënë në Haxhin e Lamtumirës: “O ju njerëz: Në të vërtetë Zoti juaj është një, babai juaj është një, nuk ka dallim arabi ndaj joarabit, as joarabi ndaj arabit, as i kuqi ndaj të ziut, e as i ziu ndaj të kuqit vetëm me devotshmëri, s'ka dyshim se më i nderuari tek Allahu është ai që ka frikën e Tij (pra ruhet nga të ligat)”.

TEK MURI I TURKUT DHE BANORËT E TIJ TË IZOLUAR...

Ruga drejt banorëve të zonës së njohur, si: Muri i turkut, kalon nëpërmjet fshatit Drisht, Postribë. Pavarësisht se jemi në vitin 2019, rruga nga Ura e Mesit drejt fshatit Drisht, ngjan më shumë me regjistrimet e vjetra filmike bardh e zi, periudhës së pas vitit 1900, a edhe më herët.

Ndërsa nga Drishti drejt Vilzës, a deri te Muri i turkut, natyrshëm që nuk bëhet fjalë më për rrugë, as për koncept vitesh, as për politika shurdhuese që propagandojnë BE, a të ngjashëm me të, ku natyrshëm, edhe fshatrat më të largëta të atyre standardeve, janë të pajisura me rrugë të shtruara, me energji elektrike, me ujë të pijshëm, me qendër shëndetësore, me shkollë e bibliotekë, etj.

Tek Muri i turkut jetojnë edhe 20 banorë të një familjeje muslimane, të izoluar nga bota! Fëmijë të vegjël, por edhe të moshuar, që nuk kanë asnjë lidhje me pjesën tjetër të botës; pa energji elektrike, pa ujë të pijshëm, pa..!?

Hera-herës më ngjajnë me personazhe librash mistikë, zahidë të heshtur e banorë kehf-esh, që nuk e dinë as ata vetë se, në ç'kohë e në ç'realitet jetojnë..!? Edhe pse, jo shumë

larg tyre, gjendet një qytet, që emrin e ka të madh, po aq sa edhe hallet e dertet, ngërçet e mendësitë abuzive, të mëkuara nga e keqja e madhe e periudhës më të errët të historisë sonë kombëtare dhe asaj që pasoi deri sot..!?

Viti 2019! Varfëria ekstreme, mjerimi e skamja, kuvendojnë e qeverisin të qetë e të patrazuar në këto vende..! Edhe pse unë besoj se, në institucionet tona ka njerëz seriozë me vullnete të forta për të ndryshuar këtë gjendje, për të gjetur një zgjidhje, për të dhuruar shpresë e dritë, edhe për këta njerëz të harruar e të izoluar në një zonë të pasur me një natyrë të mrekullueshme e florë të harlisur, që të mahnit e të befason...

Pa shkelur në këtë tokë dhe pa e vizituar atë, nuk e beson dot këtë që të shohin sytë! Pa i takuar këta njerëz të mirë dhe pa prekur shpirtgjerësinë e tyre, nuk e beson se, përreth nesh ka edhe kështu..., shumë më keq sesa shohim në qytet, shumë më shumë se varfëria në disa fshatra, shumë e shumë..!

Imam Muhamed B. Sytari

Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, 4 shkurt 2019





Sheikh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

ISLAMI KËRKON TË ECË PËRPARA ME PARIMET E TIJ TË PATUNDSHME

nuk na ka detyruar për ndonjë gjë: "Ju, jeni më të ditur në çështjet e dynjasë suaj"². Kështu është për ne, edhe në mjetet, të cilat na sigurojnë qëllimet e vendosura nga Islami, ai nuk ka vënë për to ndonjë dispozitë të veçantë, siç është ngritja e nivelit të dijes dhe moralit të ymetit, arritja e drejtësisë individuale dhe shoqërore, forca ushtarake për të luftuar në tokë, në det dhe në ajër, dhe çështje të tjera, që janë shumë, e ku pikëpamjet janë të ndryshme në shkaqe (mënyra), por jo të ndryshme në rezultate.

Pastaj, ekziston një fushë e rëndësishme, në të cilën ndryshojnë mendjet, se si të nxirren dytësoret prej parësoreve (degëzimet prej rrënjësoreve)? Që njëmijë vjet më parë apo më shumë, janë ngritur shkolla të ndryshme për këtë çështje dhe për justifikimin e ekzistencës së tyre thuhet se, nuk ka kontradiktë mes një muxhtehidi (interpretuesi) dhe një muxhtehidi (interpretuesi) tjetër i njëjtë si ai! Pluralizmi partiak në Perëndim i ngjan pluralizmin medhhebor (shkollave të fikhut) tek ne.

Ju thoni: Ne nuk marrim prej Perëndimit! Kjo thënie është e refuzuar, sepse dituria nuk ka atdhe, po ashtu edhe eksperiencat e dobishme njerëzore nuk kanë atdhe, dhe Islami porositi për të përfutur prej urtësisë kudo që të jetë dhe për ta marrë atë kudo që të ndodhet.

Ju thoni: Partitë përçajnë ymetin. Ky është një kundërshtim qesharak!

Ymetin e përçajnë eposhet (egot) dhe

jo pikëpamjet e ndryshme të dëlira. Partitë kanë lindur që me lindjen e ekzistencës së Izraelit mbi kurrizin tonë dhe çfarë i ndodhi atyre, e çfarë na gjeti ne??

Ky lloj sistemi nuk e ka dëmtuar Perëndimin dhe mungesa e tij nuk i ka bërë dobi Lindjes komuniste, ndërsa zhytja, se ai është hallall apo haram, kjo është shenjë marrëzie.

E habitshme është, se brezat e mëvonshëm të myslimanëve e kanë zënë veten e tyre me lloje të ndryshme mendimesh apo kanë paralizuar hapat e tyre me lloje prangash, që e kanë lënduar pa masë Islamin!

Islami kërkon të ecë përpara me shtyllat e tij të shëndosha dhe parimet e tij të patundshme, ndërkohë që njerëzit thonë: Mvëshjani këtyre shtyllave dhe parimeve vendimet e mëposhtme: Veshja e rrobave perëndimore është haram, zbulimi i fytyrës së femrës është haram, kënga është haram, fotografimi është haram, kolonja është haram, ndërtimi i ndërtesave të larta është haram, shkuarja e femrave në xhami është haram etj.

Këto shtojca të frikshme që i janë shtuar Fjalës së Tevhidit dhe ndoshta i paraprijnë prezantimit të Islamit tek njerëzit, e si do të ecë përpara Islami me gjithë këto pesha të rënda?

Ai, në këtë gjendje që është, jo vetëm nuk do të fitojë terren të ri, por madje do të humbasë edhe vetë tokën e tij.

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja

E HABITSHME ËSHTË, SE BREZAT E MËVONSHËM TË MYSLIMANËVE E KANË ZËNË VETEN E TYRE ME LLOJE TË NDRYSHME MENDIMESH APO KANË PARALIZUAR HAPAT E TYRE ME LLOJE PRANGASH, QË E KANË LËNDUAR PA MASË ISLAMIN!

Në një prej fakulteteve të Sheriatit, në të cilat jepja mësim, dikush më pyeti: A, e lejon Islami rinovimin e mandatit të presidentit të republikës?¹

Një mendjelehtë nxitoi duke thënë: Jo, ky është bidat, kjo është haram!

I thashë: Nga nxore këtë haram?

Nëse, kolegji konsultativ vendos për një interes të dobishëm, e miraton mendimin e vet dhe merr vendim mbi këtë bazë; nuk ka haram, vetëm se me argument, dhe jo çdo gjë e re, që nuk ka qenë në periudhën e Shpalljes dhe të kalifatit, cilësohet se është bidat. Studioni rregullat e interesave të përgjithshme (el-maslahatu el-mursele), që ta mësoni tërë çështjen.

Një tjetër pyeti: A, e pranon Islami pluralizmin partiak?

Një mendjelehtë tjetër thirri: Jo, ky është bidat i importuar nga Perëndimi.

Islami nuk e ndalon pluralizmin e mendimeve (pikëpamjeve) dhe ndryshimin mendor në programet e reformimit fetar apo jofetar. Ne, në çështjet e kësaj bote jemi të lirë, Islami

1. Nga libri: "Mustakbelul-Islam harixh erdihi".

2. Hadith profetik.



Admir Plaku,
Imam - xhamia "Ebu Bekër"

BESIMI ËSHTË GJALLËRIM PËR JETËN

duket mirë mohuesve ajo që veprojnë.³ Dallimi i besimtarit nga ai që mohon ekzistencën e Allahut (xh.sh) duket qartë sipas kësaj dëshmie kur'anore.

Për besimtarin ka përherë dritë që ecën me të ndër njerëz. Vallë çfarë është kjo dritë që buron nga jeta e besimtarit. Pa dyshim që ajo është drita e ndërgjegjes që përshkon çdo gjymtyrë të tij, dallon me të të mirën nga e keqja. Njeriu duke besuar forcon dritën e ndërgjegjes dhe frymon jetë të re. Me këtë dritë ai shikon atë çfarë nuk arrin të dallojë jobesimtari, fiton një pozitë të veçantë jo vetëm tek Allahu por edhe në shoqëri. Allahu (xh.sh) i barazoi njerëzit në krijim por i gjallëroi, i dalloi dhe i lartësoi me besim.

Falë besimit në Allahun (xh.sh) njeriu doli nga errësira e injorancës, hoqi perden e verbërisë së mosbesimit. E me të drejtë Allahu (xh.sh) thotë: "Nuk janë, kurrsesi, njësoj i verbëri dhe ai që sheh, as errësira dhe drita, as freskia (e hijes) dhe vapa. Po ashtu, nuk janë kurrë të barabartë të gjallët dhe të vdekurit...". Pa dyshim që besimi në Allahun (xh.sh) është jetë aktive dhe jo pasivitet. Jo pa qëllim Allahu (xh.sh) e ka quajtur shpalljen shpirt, kjo për faktin se gjallëron zemra të vdekura dhe ndërgjegjëson karaktere të prishura. Ky është edhe dallimi mes besimit të vërtetë dhe atij të dobët. Besimi i fortë ka ndikim në jetën e njeriut. Ndikimin e besimit në jetën e njeriut Pejgamberi (a.s) e ka krahasuar me efektin e shiut në tokë.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Shembulli i udhëzimit dhe i diturisë me të cilën Allahu më ka dërguar është si shembulli i shiut që bie në tokë. Toka pjellore e thith këtë shi dhe nga ajo mbijnë shumë bimësi dhe kullota. Toka jopjellore e ruan këtë ujë dhe Allahu bën që njerëzit ta shfrytëzojnë atë për pije (për vete), për bagëti dhe për ujë. Ndërsa toka ranore nuk e ruan ujën dhe nga ajo nuk mbijnë bimët dhe kullotat. I njëjti është rasti edhe me atë që e kupton fenë dhe përfiton prej asaj me të cilën jam dërguar unë dhe mësoi vetë dhe i mëson të tjerët. Në fund është shembulli i atij që nuk ka konsideratë e as që e pranon udhëzimin e Allahut me të cilin unë jam dërguar."⁴ Vërtetë që kur

shiu bie në tokë pjellore ndikon në të dhe e bën të gatshme për bimësi ndërsa kur bie mbi gurë tregon ashpërsinë dhe varfërinë e tij. Po kështu ndodh edhe me ndikimin e besimit në jetën e njeriut. Allahu (xh.sh) i tërhoqi vëmendjen njeriut nga një e keqe e madhe për besimin e tij siç është formaliteti.

Dyfytyrësia e shkatërron besimin dhe e vdes zemrën e njeriut. Ajo shkatërron veprat dhe nxjerr zbuluar zbrazëtinë e zemrës nga domethënia e së mirës, zbeh ndikimin e ibadetit në jetën e njeriut. Në këtë kontekst Allahu (xh.sh) na e sjellë si shembull duke thënë: "Shembulli i tij është si një gur i madh e i lëmuar që mbi të ka pak dhë, e kur e godet atë një shi i madh e lë të zhveshur (lakuriq). Ata formalistët nuk arrijnë asgjë nga ajo që punuan. Allahu nuk e udhëzon popullin jo besimtarë."⁵

Si në çdo aspekt të jetës që formaliteti është i urryer edhe në çështje të besimit Allahu (xh.sh) na tërheq vëmendjen që të mos jemi viktimë e formalitetit në besim dhe vepra. Në një gjendje të tillë njeriu vdes para se të vdesë, është larg jetës së dëshiruar nga Allahu (xh.sh). Sikur të logjikoni pak një gjendje të tillë do të kuptoni se ruajtja e besimit të pastër nga dyshimi e formaliteti ka më rëndësi se ruajtja e çdo gjëje tjetër.

Në jetën e cila frymon besim nuk ka vend për dyshim e pesimizëm pavarësisht vështërsive që hasen. Allahu (xh.sh) thotë: "Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk dyshojnë...".⁶ Të jetuarit me besim nuk ka hapësirë të kufizuar apo vend të përcaktuar, kudo që besimtari të gjendet duhet të jetojë me besim dhe moralin që buron prej tij. Vetëm besimi në Allahun (xh.sh) e gjallëron jetën e njeriut, prandaj atë që Allahu (xh.sh) e ka udhëzuar në besim, i ka dhuruar mirësinë më të madhe si në jetën e kësaj bote ashtu dhe në ahiret. Le të themi atë që ka urdhëruar: "Dhe thuaj: Falenderimi qoftë për Allahun, Ai do t'jua tregojë shenjat e Tij e ju do t'i njihni ato! E Zoti yt, nuk është i pakujdesshëm ndaj veprave që ju bëni".⁷

5. Kur'ani, El-Bekare: 264.
6. Kur'ani, El-Huxhurat: 15.
7. Kur'ani, En-Neml: 93.

1. Kur'ani, El-Enfal: 24.
2. Kur'ani, Ali Imran: 193.

3. Kur'ani, El-En'am: 122.
4. Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Musa Esh'arij.

KONFERENCA E 8-TË VJETORE E IMAMËVE, MBI POZITAT E GRUAS NË ISLAM

Paraditën e së shtunës, më 23 shkurt 2019, u zhvillua konferenca e 8-të vjetore e imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës.

Në qendër të vëmendjes ishte pozita e gruas në Islam, tematikë që u trajtua në 16 referate, të ndara në dy seanca.

Referatet e përgatitura nxorën në pah madhësinë e Islamit në raport me pozitën e gruas, në të gjitha etapat e saj, krahasuar me qytetërimet dhe besimet e tjera, ku akoma sot, gruaja konsiderohet si e papastër, e keqe e domosdoshme, e padenjë për jetën, objekt joshjeje dhe e krijuar për epshet mashkullore, reklamë tunduese për botën, etj.

Në konferencë u spikat roli i muslimaneve në edukimin e brezave dhe përhapjen e qytetërimit islam ndër shekuj, si dhe lartësimin që i ka bërë Islami nëpërmjet Kur'anit dhe Traditave profetike, pozitës së femrës në jetë, duke e vlerësuar atë si nënë, si bashkëshorte, si motër e bijë, si dhe duke mbrojtur nga padrejtësia dhe shthurja në jetë.

Ndërkohë, në referatin e tij dhe mesazhin para imamëve, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ndër të tjera tha: “Por, ajo që është më e rëndësishme për t’u përmendur në këto kontekste, është se cila është detyra e imamëve, vaizeve, thirrësve islamë në drejtim të thirrjes me urtësi e largpamësi, larg tendencave të ekstremizmit dhe leximit të cungët të

teksteve dhe fetvave, që shpesh kanë ndikuar në etiketimin e fesë islame me çfarë nuk e meriton dhe me çfarë nuk është në realitet!

Ku jemi në drejtim të përhapjes së mësimave qytetëruese të fesë tonë dhe edukimit fetar të brezit të ri, në realitetet e mungesës së lëndës së edukatës fetare në shkollat e vendit tonë, si dhe përtej demagogjisë së premtimeve elektorale dhe tendencave të përhapjes së ateizmit dhe afetarizmit, edhe nëpërmjet tribunave politike dhe ithtarëve të rinj të frymërave të reja që e duan shoqërinë njerëzore larg besimit dhe fesë, larg disiplinës së besimit dhe përkushtimit ndaj Fjalës së pandryshuar të Zotit; Kur'anit Famëlartë, si garanci e padiskutueshme dhe krejtësisht e mundshme për ndreqjen e asaj që dekada e shekuj kanë prishur në jetën e njeriut!”

Në këtë konferencë referuan: Imam Muhamed B. Sytari, teologët Gilman Kazazi, Lavdrim Hamja, Durim Kasemi, Idmir Plaku, Arben Halluni, Adem Pizga, Ervil Kuçi, Naim Driaj.

Ndërkohë, tek seanca e teologeve dhe vaizeve, referuan teologët: Arta Ujkaj, Elona Sytari, Zamira Puka, Ferzet Ndoja, Adelina Muça, Jetmira Plaku dhe Drita Muça.

Konferenca u përshëndet edhe nga Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj.



PYETJET E KRIJUESIT NDAJ KRIJESAVE TË TIJ!

PYETJET E KRAHASIMIT DHE BARAZISË

Mendja e njeriut funksionon mbi bazën e krahasimeve. Ajo ndërton ngjashmëri dhe kontraste midis sendeve, personazheve apo ngjarjeve. Vlerëson mbi bazën e parimit shkak-pasojë dhe disa gjëra i kupton vetëm përmes të kundërtës.

Për këtë arsye në Kur'anin Famëlartë shpesh sillen pranë njëra-tjetrës dy nocione të kundërta si:

Besimi dhe mohimi, singëriteti dhe hipokrizia, xhenneti dhe xhehennemi, i devotshmi dhe i prishuri, udhëzimi dhe humbja...

Vlerësimet e mendjes njerëzore ndaj situatave të caktuara shpesh janë sipërfaqësore. Njeriu mund të bëjë vlerësime të gabuara duke u mashtruar nga ana e jashtme. E jashtëmja shpesh bëhet instrument vlerësimi, por e vërteta është se feja ka karakter të brendshëm dhe të thellë dhe nuk mjaftohet vetëm me sipërfaqësoren.

Pyetjet “A janë të barabartë?” dhe gjykimet “X dhe Y nuk janë të barabartë” përbëjnë një stil të përdorur në Kur'anin Famëlartë. Mund të themi se përmes këtij stili janë arritur qëllimet e mëposhtme:

Stimulimi i ndjenjave dhe mendimit fetar përmes natyrshmërisë së besimit dhe mekanizmit të krahasimit.

Shkëputja nga krahasime të cekëta dhe pa tipare dalluese drejt një logjike dhe vlerësimi më të thellë.

Bindja përmes mendjes dhe pajtimi përmes ndërgjegjes se duhet qëndruar larg një botëkuptimi djallëzor dhe egoist.

Përgatitja e terrenit të duhur për të pranuar të drejtën dhe të vërtetën si rezultat i largimit nga e kota.

MENDJEHAPUR

Krijuesi i gjithësisë çdo krijesë të Tijën e ka pajisur me veçori të natyrshme, ashtu sikurse edhe njeriut i ka dhuruar veçori të tilla si mendja, ndërgjegjja dhe logjika për të qenë i aftë të jetojë në këtë botë dhe të gjejë rrugët e shpëtimit në botën tjetër.

Logjika në fakt fillon të shfaqet që në fëmijëri me dallimin që bën fëmija mes të dobishmes dhe të dëmshmes. Më pas me shumëfishimin e rasteve të së dobishmes dhe së dëmshmes, tek njeriu logjika dhe arsyetimi fillojnë të marrin një kuptim edhe më të thellë. Disa njerëz mund të

harxhojnë paratë që kanë në emër të kënaqësive të përkohshme duke kaluar në shpërdorim dhe mendjemadhësi e më pas duke vuajtur në kurriz pasojat. Këtyre personave në gjuhën e jurisprudencës islame u thuhet “sefi”, mendjelehtë, të paafte për të kontrolluar dëshirat e tyre e kështu për të zbatohen disa masa ligjore. Persona të tillë edhe pse në moshë madhore nuk janë të aftë të përdorin trurin e tyre. Zotërojnë mendje, por jo pjekuri. Në një farë mënyre mendja shfaqet në dukje, por në thellësi ajo mungon.

Njeriu dallon dritën nga errësira dhe vlerëson të parën mbi të dytën, sepse njeriu nuk arrin të shohë në errësirë, është i verbër, e duke mos qenë i aftë të kontrollojë errësirën ajo është e mbushur me rreziqe. Rreziku është shkatërrim, vdekje. Ai i cili nuk e sheh rrugën, përumbet në të.

“Drita”, “shikimi”, “kuptimi” dhe “udhëzimi”...

Le të lexojmë:

“Nuk janë, kurrësi, njësoj i verbëri dhe ai që sheh, as errësira dhe drita, as freskia (e hijes) dhe vapa. Po ashtu, nuk janë kurrë të barabartë të gjallët dhe të vdekurit. Allahu bën të dëgjojë kë të dojë Vetë, kurse ti (Muhamed) nuk mund të bësh të dëgjojnë ata që janë në varre.” (Fatir, 19-22)

AFTËSI E KUFIZUAR

Në ditët e sotme është shfaqur një tjetër qasje e përdorimit të termave sa më të zbutur sa i takon personave me aftësi të kufizuara fizike. Kështu në vend të termave “qorr”, “i verbër”, “shurdh”, “memec” etj. po përdoret termi “person me aftësi të kufizuara”.

Në Kur'anin Famëlartë fjalët dhe konceptet në kuptimin e vërtetë dhe metaforik janë përdorur si një mjet i fortë meditimi, andaj dhe qasja e mësipërme e përdorimit të termave të zbutur nuk është një qasje që rëndomë haset në Kuran. Kështu nëse në Kuran si term përdoret fjala “qorr”, këtu aludohet për personin zemra e të cilit është “e verbër”. (el-Haxhxh, 46; el-Isra, 72). Kur përdorim të tilla shprehje si: “Hapi sytë, a je qorr? Fshati që shihet nuk do kallauz! Hapi sytë katër! Bëhu syhapur! Mos i mbyll sytë ndaj gabimeve! Mos u bëj i verbër ndaj okazioneve. Shurdh memecët gostisin njeri-tjetrin.” sigurisht që qëllimi ynë nuk është të ofendojmë personat që kanë

mangësi fizike.

Krijuesi i Gjithësisë i përshkruan fe mohuesit si persona syri i zemrës i të cilëve është verbuar, të mbetur në errësirën e femohimit e si rezultat të shkatërruar e me zemër të vdekur.

Le të lexojmë:

Dallimi midis këtyre dy grupeve (besimtarëve dhe fe mohuesve) shëmbëllen me dallimin midis një të verbri të shurdhër dhe një njeriu që sheh e dëgjon. A janë të njëjtë këta (kur të krahasohen)? A nuk po merrni këshillë?! (Hud, 24)

4 ajete më përpara Allahu përshkruan anën shpirtërore të këtij të verbri e të shurdhti:

Nuk janë ata që kanë pushtetin në Tokë dhe nuk do të kenë ndonjë mbrojtës tjetër, në vend të Allahut. Atyre do t'u shumëfishohet dënimi, sepse as nuk dëgjonin, as shihnin. (Hud, 20)

-A është i barabartë ai që sheh me atë që nuk sheh?

-Në cilën fushë?

Punët e mira të një besimtari të verbër me punët e mira të një besimtari që sheh, në vlerësim janë të barabarta. Kjo do të thotë që Krijuesi nuk e përcmon një person me aftësi të kufizuara siç mund të ndodhë rëndomë në shoqëri. Përkundrazi, atij i jepen shpërblime edhe më të mëdha si rezultat i durimit, kënaqësisë dhe nënshtrimit ndaj kaderit të Zotit.

Pyetja: “A është i barabartë ai që sheh me atë që nuk sheh?” ka për qëllim kërkesat dhe objektivat e natyrshme të njeriut. Nëse ju prisni një fëmijë, nuk ka shumë rëndësi nëse ai është zeshkan, esmer apo biond? Por a mund të mos ketë rëndësi nëse ai sheh apo nuk sheh? Kurrë! Do të luteshit ditë natë që ai të shihte.

E pra, si mundet që Krijuesi i Gjithësisë t'i konsiderojë të njëjtë ata që syrin e zemrës e kanë të hapur me ata që i janë rebeluar Atij? Si mund t'i quajë të njëjtë besimtarin me femohuesin? Natyrshëm nuk mundet. Dallimi që ekziston midis tyre është shumë më i madh se dallimi që ne shohim midis një të verbri dhe një personi që sheh.

E ç'faj ka i verbri?

Mund të lind natyrshëm kjo pyetje. Në letërsi ekziston një rregull: nuk është kusht që një krahasim figurativ të jetë domosdoshmërisht edhe krahasim absolut. P.sh. ushtari përngjasohet

me luanin, por me çfarë? Me guximin, trimërinë, forcën e fuqinë! Përkundrazi, të qenurit kafshë, me bisht e të tjera cilësi nuk mund të jenë qëllimi i përngjasimit.

Atëherë themi se verbëria është dy llojesh:

Fizike, jo në dorën e personit, e jashtme, një karakteristikë që nuk përbën një mangësi shpirtërore

Shpirtërore, një zgjedhje e vetë personit si rezultat i kokëfortësisë dhe gjynaheve të tij, e brendshme, diçka që të shpie në xhehennem.

I verbri nuk ka asnjë faj. Fajtor është ai i cili me kokëfortësinë e tij vazhdon të mos shohë. Në një farë mënyre në të gjithë gjuhët e botës të shikuarit nënkupton edhe të kuptuarit. Thirrja për të shikuar është edhe thirrje për të kuptuar: Thuaj: “A barazohet i verbri me atë që sheh? A s'po mendoni?” (el-Enam, 50)

Në stilin e Kur'anit shpesh ajo çka nënkuptohet me “të verbërin” janë idhujt:

Thuaj: “Kush është Zoti i qiejve dhe i Tokës?” dhe përgjigju: “Allahu!” Thuaj: “A mos vallë, ju zgjidhni për mbrojtës në vend të Tij, ata që nuk mund t'i sjellin vetes as dobi, as dëm?” Thuaj: “A janë të njëjtë i verbëri dhe ai që sheh? Ose a janë njësoj terri dhe drita? Apo ata (idhujtarët) i veshin Allahut ortakë, të cilët krijojnë siç krijon Ai, kështu që krijimi u ngjan i njëjtë atyre (idhujtarëve)?!” Thuaj: “Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është i Vetmi, Ngadhënjimtari”. (Er-Rad, 16)

Në disa ajete më pas ajo çka nënkuptohet me “të verbërin”, është femohuesi që nuk arrin dot të shohë të vërtetën: Vallë, ai që di se ajo që të është shpallur ty (Muhamed) nga Zoti yt është e vërteta, a është njësoj me atë që është i verbër (ndaj këtij fakti)? Vetëm njerëzit që kuptojnë ia vënë veshin kësaj. (Er-Rad, 19)

“Ai që sheh” nuk është vetëm ai që beson por edhe ai që bën punë të mira:

Nuk janë njësoj i verbëri dhe ai që sheh; as ai që beson e bën vepra të mira nuk është i barabartë me atë që bën keq. Sa pak që mendoni! (Gafir, 58)

Mendja njerëzore është e prirur t'i grupojë në të njëjtën kategori ata që në dukje janë të ngjashme. Besimi është një çështje e brendshme e zemrës e cila nuk mund të shihet plotësisht, andaj besimtari dhe femohuesi në dukje mund të shihen si një, por tek Allahu sigurisht që janë të ndryshëm si drita me errësirën.

(vazhdon në numrin e ardhshëm)

Autor: **Mustafa Asım KÜÇÜKAŞÇI** (YÜZAKI, Korrik 2018)

Përktheu dhe përshtati: **Elona SYTARI**

NË NDIHMË TË NJERËZVE NË NEVOJË

Paraditën e së shtunës, më 2 shkurt 2019, falë kontributit të Fondacionit “Mirësia”, u bë e mundur ndihmesa e një familjeje të varfër në zonën e Postribës.

realitetet e zonave të ndryshme, sidomos Postribës, mbeten një njollë e madhe turpi në hartën e vendit.

Përtej thirrjeve të shumta të bëra nga imamët dhe xhamitë tona, si dhe përtej



I pranishëm ishte edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, që falënderoi mbështetjen e madhe të Fondacionit “Mirësia” dhe drejtorit të saj, z. Korab Kaja, që kishte ardhur me këtë rast.

Mjerimi dhe skamja, në përhapje kudo në vendin tonë, ka dekada që ka përfshirë edhe zonën e Postribës, sikurse edhe qytetin e Shkodrës, ku të shumta janë familjet me probleme ekonomike.

Për shkak të qeverisjes së keqe,

ndihmave të shumta nga ana e shoqatave bamirëse islame dhe Myftinisë Shkodër, realitetet janë këto, përtej premtimeve të pambajtura të deputetëve dhe partive politike, që vijnë vërdallë, sidomos në prag të fushatave elektorale!

Myftinia Shkodër tërheq vëmendjen e institucioneve dhe përfaqësuesve të popullit, që të kenë frikë Zotin dhe të dëshmojnë përgjegjësi dhe pjekuri në trajtimin e situatave aspak të pranueshme të mjerimit dhe skamjes, ku është zhytur vendi!

NË NDIHMË TË NJERËZVE TË IZOLUAR TE MURI I TURKUT

Ditën e hënë, më 4 shkurt 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i shoqëruar edhe nga aktivistë të Myftinisë, vizitoi banorët e izoluar tek Muri i turkut.

Gjatë vizitës së tij, Myftiu u interesua për gjendjen e 20 banorëve të një familjeje të madhe atje, të cilët jetojnë në mjerim e skamje të madhe, të izoluar nga zona e Postribës dhe qyteti i Shkodrës.

Përtej ndihmave paraprake, Myftiu diskutoi edhe mundësinë e një ndihmese sistematike për këta banorë, në mënyrë që të lehtësohet sadopak gjendja e keqe ku ndodhen, pa asnjë pension a përkrahje ekonomike, pa punë të qëndrueshme e të ardhura.





Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Ebu Hurejra (r.a) transmeton se i Dërguari i Allahut u ka thënë një ditë shokëve të tij: “A dëshironi t’ju tregoj për ato vepra me anë të të cilave Allahu ua fshin gjynahet dhe ua lartëson gradat tuaja në xhenet?” Ata thanë: “Po”, o i Dërguari i Allahut. Atëherë Pejgamberi (a.s) tha: “Përsosja e abdesit edhe në kushte të vështira (si i ftohti etj), hapat e shpeshtë për në xhami dhe pritja e namazit (tjetër) pas kryerjes së namazit të mëparshëm.”¹ Të tria këto vepra janë të lidhur me një adhurim që është shumë i rëndësishëm në islam i cili është namazi.

1. Përsosja e abdesit edhe në kushte të vështira. Jemi të urdhëruar që ta përkryejmë abdesin çdo herë, ndërsa në dimër dhe në raste vështirësie shpërblimi shtohet edhe më shumë.

Ebu Hurejra (r.a) tregon, se i Dërguari i Allahut (Paqja qoftë mbi të) ka thënë: “Kur muslimani apo besimtar merr abdes dhe lan fytyrën, çdo gjynah që ka parë syri i tij, bie me ujin e fytyrës apo me pikën e fundit të ujit që bie. Kur lan duart, çdo gjynah që dora e ka prekur, bie me ujin, ose me pikën e fundit të ujit. Kur lan këmbët, çdo gjynah për të cilin këmba ka ecur për ta kryer, bie me ujin, ose me pikën e fundit të ujit. Kjo vazhdon, derisa robi pastrohet tërësisht nga gjynahet.”² Uthmani (r.a) tregon se Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Atij që merr abdes në formën më të mirë, i bien të gjitha gjynahet nga trupi, madje gjynahet i bien edhe nga poshtë thonjve.”³

Një ditë Pejgamberi (a.s) u tha shokëve të tij: “Sa më ka marrë malli për vëllezërit e mi”. Sahabët i thanë: “O i Dërguari i Allahut! A nuk jemi ne vëllezërit e tu? Ai tha: “Ju jeni shokët

VEPRAT QË NA AFROJNË ME ZOTIN

e mi. Vëllezërit e mi janë ata, të cilët nuk kanë ardhur ende”. E pyeten: “O i Dërguari i Allahut! Si do t’i njohësh vëllezërit e tu, kur ata nuk kanë ardhur akoma në jetë”? Ai (Paqja qoftë mbi të) tha: “Nëse dikush do kishte kalin e tij me njolla të bardha në ballë dhe në këmbë mes një tufe kuajst të zinj, a do ta njihje ai kalin e tij”? I thanë: “Patjetër që po, o i Dërguari i Allahut”. Ai (a.s) tha: “Ata do të vijnë me dritë në fytyrë dhe në gjymtyrë nga gjurmët që ka lënë abdesi.”⁴

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Umeti im do të shfaqet me dritë në gjymtyrët e abdesit, për shkak të gjurmëve të abdesit. Cilido prej jush që ka mundësi ta zgjasë dritën, le ta bëjë atë.”⁵ Ebu Hurejra (r.a) ka thënë, se e kam dëgjuar mikun tim, të Dërguarin e Allahut të thotë: “Zbukurimi e përfshin besimtarin (në xhenet), deri aty ku ka arritur abdesi.”⁶ Preferohet që gjatë marrjes së abdesit, disa gjymtyrë të lahen më shumë. P.sh: krahët të lahen deri afër sqetullave, fytyra të lahet deri tek rrënjët e flokëve dhe këmbët të lahen deri afër gjurit.

2. Hapat e shpeshtë për në xhami. I Dërguari i Allahut ka thënë: “Sa herë që besimtar shkon në xhami, Allahu i përgatit atij një vend në xhenet.”⁷

Qëllimi i këtij hadithi është vlere e vajtjes në xhami për ibadet, adhurim ndaj Allahut, dhe ajka e ibadeteve është namazi. “Për çdo hap që bën (muslimani) drejt xhamisë (për të falur namaz), Allahu e lartëson pozitën e tij një shkallë dhe ia fshin një gjynah.”⁸ “Kush ecën për në xhami (për të falur namazin me xhematë), një hap ia fshin një gjynah dhe një hap tjetër ia shton një të mirë, në vajtje dhe në kthim.”⁹

3. Pritja e namazit (tjetër) pas kryerjes së namazit të mëparshëm. Është e pëlqyeshme që një besimtar të presë namazin në xhami nëse ka kohë të lirë. Një qëndrim i tillë duke pritur namazin ka shpërblim të madh. Këtë qëndrim po e kushtëzojmë me të qenurit i lirë, sepse përndryshe muslimani e ka detyrë që të kërkojë furnizimin dhe begatinë e Allahut dhe të mos bëhet barrë e

nevojtar për njerëzit e tjerë. Allahu (xh.sh) thotë: “Dhe, kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, kërkon nga mirësitë e Allahut dhe përmendeni sa më shumë Allahun, në mënyrë që të shpëtoni.”¹⁰ Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Melekët do të vazhdojnë të luten për atë, i cili qëndron në vendin ku u fal, duke thënë: “O Allah, fale! O Allah mëshiroje!” (kjo lutje do të vazhdojë) derisa personi ta prishë abdestin. Çdonjëri nga ju do të vazhdojë të ketë sevapet e të qëndruarit në namaz, përdërisa është duke pritur namazin. Nuk e pengon atë të kthehet në shtëpinë e tij, veçse namazi.”¹¹

Qëndrimi i besimtarit në xhami është një vepër e pëlqyeshme, sidomos kur kjo gjë shoqërohet me leximin e Kur’anit, me përmendjen e Allahut (dhikrin), me qëndrimin në i’tikaf, me prezantimin e një ligjëratë apo me pritjen e namazit. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Me të vërtetë xhamitë kanë frekuentues të rregullt me të cilët qëndrojnë melekët; nëse mungojnë, melekët pyesin për ta; nëse sëmuren, melekët i vizitojnë ata; nëse janë në nevojë, melekët i ndihmojnë ata.”¹²

“Kur muslimani shkon vazhdimisht në xhami për të falur namaz dhe për të përmendur Allahun, Allahu gëzohet me të që kur del nga shtëpia, ashtu siç gëzohet familja kur i kthehet asaj një pjesëtar nga larg.”¹³ Ebu Derda e ka këshilluar djalin e tij duke i thënë: “O djali im, le të jetë xhamia shtëpia (vendqëndrimi) jot, sepse e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s) duke thënë: “Xhamitë janë vendqëndrimet e njerëzve të devotshëm. Kush e ka xhaminë për vendqëndrim, Allahu i garanton atij mëshirën dhe kalimin e sigurt mbi urën e siratit.”¹⁴ Xhamia është shtëpia e Allahut dhe ne jemi mysafirët e Tij për sa kohë qëndrojmë në xhami. Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kush merr abdest në shtëpi dhe e plotëson abdestin e tij (me sunete), pastaj vjen në xhami, ai konsiderohet mysafir i Allahut. Dhe është e drejtë e Allahut (i takon Atij) ta nderojë mysafirin.”¹⁵

10. Kur’ani, El-Xhumua: 10.

11. Buhariu.

12. Ahmedi.

13. Ahmedi.

14. Taberaniu.

15. Taberaniu.

NË RRUGË TË MBARË XHAMIA DHE QENDRA KULTURORE NË OBLIKË

Ditën e mërkurë, më 6 shkurt 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari zhvilloi një inspektim në terren, ku ndoqi nga afër arritjet e deritanishme në prag të përfundimit të këtij kompleksi fetar dhe kulturor, me shumë rëndësi për banorët e zonës së Anës së Malit.

Myftinia Shkodër është e interesuar që në çdo lagje dhe në çdo fshat, ku jetojnë muslimanë në zonën e Shkodrës, të ngrihen xhami të reja, qendra kulturore, libroteka, salla sportive, salla leximi dhe ambiente bashkëkohore në shërbim të komunitetit.

Xhamia e re dhe qendra kulturore e fshatit Oblikë, pritet t’i shërbejnë krejt zonës, që prej kohësh e kishte nevojshme një investim të tillë.

Ndërkohë, Myftinia Shkodër në bashkëpunim edhe me Njësinë Administrative Ana e Malit, Bashkinë Shkodër dhe institucione të tjera, po



bën të gjitha përpjekjet për pastrimin e vakëfit të Oblikës nga ndërtimet pa leje, të cilat jo vetëm që e shëmtojnë pamjen e zonës, por janë bërë pengesë evidente për përfundimin e plotë të projekteve të Myftinisë në këtë zonë.

Për këtë, bashkëpunimi me komunitetin dhe personat e përfshirë në këtë çështje, është i një rëndësie të veçantë.

“KUR’ANI NË JETËN E MYSLIMANËVE”, NJË MBRËMJE PLOT VLERA BESIMI



Ditën e mërkurë, më 13 shkurt 2019, pas faljes së namazit të akshamit në xhaminë e “Dy Vajzave”, Myftinia Shkodër organizoi aktivitetin me temë: “Kur’ani në jetën e myslimanëve”.

Krahas pjesëmarrjes së shumë besimtarëve, medresistëve, nxënësve të Qendrës së Hifzit të Kur’anit në Shkodër, merrnin pjesë edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, Myftiu i Librazhdit, z. Ardit Hoxhllaku, Drejtori i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, z. Kujtim Dervishi, imamë të xhamive, teologë, etj.

Në hapjen e këtij aktiviteti, teologu Arben Halluni tha se kjo mbrëmje me

vlere fetare e besimore ka një rëndësi të veçantë, sepse ka të bëjë me Librin e All-llahut (xh.sh.), Kur’anin Fisnik, që është garanti dhe anija e shpëtimit për çdo besimtar dhe njeri që kërkon rrugën e udhëzimit dhe të shpëtimit.

Më pas, Imam Muhamed B. Sytari ligjëroi para të pranishmëve rreth temës: “Rreth përkthimit të kuptimeve të Kur’anit Famëlartë në gjuhët e botës”, shoqëruar me ekspozitën e ngritur enkas për këtë aktivitet.

Ndërsa imami i xhamisë së “Dy Vajzave”, teologu Lavdrim Hamja foli rreth temës: “Kujdesi i myslimanëve ndaj Kur’anit Famëlartë”.

NGUSHËLLIM!



“Të All-llahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi!”

Ngjarja e rëndë e ndodhur mbrëmjen e kaluar në Gostivar, na ka lënduar pa masë, sikurse na fton që të lutemi për njëri-tjetrin, jo vetëm në raste të tilla, të mbushura plot dhembje e lot.

Lutjet tona në këto momente janë për shpirtat e të dashurve, që humbën jetën dhe për shërimin e të lënduarve të kësaj ngjarjeje rrënqethëse!

Ngushëllime të përzemërta për familjarët, të afërmit dhe bashkëqytetarët e udhëtarëve, që humbën jetën si pasojë e këtij aksidenti të rëndë!

Myftinia Shkodër, 14 shkurt 2019

Nëpërmjet materialeve plot dobi, të shfaqura me videoprojektor, ai nxori në pah historikun e përkujdesjes së myslimanëve për Kur’anin Famëlartë përgjatë historisë.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Librazhdit, H. Ardit Hoxhllaku, që zhvilloi sot edhe një vizitë në Myftininë e Shkodrës.

Aktiviteti vijoi me ekspozitën e pasur, që tërhoqi vëmendjen dhe interesin e të pranishmëve, për përmbajtjen e saj.

Pas faljes së namazit të jacies me xhemat, të pranishmit drejtuan pyetje të ndryshme në lidhje me tematikën e këtij aktiviteti plot dobi.



MYFTIU BASHKËBISEDOI ME TEOLOGET E MEDREDESË



Paraditën e së mërkurës, më 13 shkurt 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me teologët e Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, dega e vajzave.

Në qendër të këtij takimi ishte konferenca e 9-të vjetore e imamëve, teologëve, vaizeve dhe thirrësve islamë të Shkodrës, që zhvillohet zakonisht në fund të muajit shkurt të çdo viti.

Myftiu vlerësoi kontributin e mësueseve edukatore, që kanë një përgjegjësi shumë të madhe në edukimin e brezit të ri me frymën e dashurisë për All-llahun dhe fenë e Tij.

Njëkohësisht, u diskutua edhe mbi rrugët e shtimit të aktivitetit për motrat muslimane dhe rininë, në kuadër të aktivitetit të përvitshëm të Myftinisë Shkodër.

MYFTIU PRITI DREJTORIN E QENDRËS KULTURORE “YUNUS EMRE”



Paraditën e së martës, më 19 shkurt 2019, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, z. Zafer Kırııcı, drejtor i Q.K. “Yunus Emre”, Shkodër.

Gjatë takimit, Myftiu falënderoi kontributin e Q.K. “Yunus Emre”, në drejtim të përhapjes së urave që lidhin dy popujt tanë, nëpërmjet aktiviteteve të larmishme, që mbushin sadopak boshllëqe të krijuara ndër vite në realitetet e shoqërisë tonë.

Poashtu vlerësoi mundësinë e bashkëpunimit në fusha të përbashkëta,

si: trashëgimia kulturore e fetare, gjurmët osmane në traditat shqiptare, kontributet e intelektualëve tanë në fusha të ndryshme të dijeve orientale, etj.

Nga ana e tij, z. Kırııcı, shprehu falënderimet për Myftininë e Shkodrës, sikurse bëri një prezantim të aktivitetit të Q.K. “Yunus Emre”, larmishmërisë së tij dhe planifikimit për periudhën në vijim.

Në fund, pas këmbimit të dhuratave simbolike, Myftiu dhe z. Kırııcı shprehën vullnetin e takimeve të mëtejshme me dëshirën e bashkëpunimit të vazhdueshëm.



Sa shumë e dëmtojnë sfenë disa praktikantë të fesë!?

Ndonjëri prej tyre ndjek me korrektësi faljen e namazeve me xhemat në xhami, por ai është i pasjellshëm me gruan dhe fëmijët e tij!

Ndonjëri prej tyre mburret me gjatësinë e mjekrës që mban, por mashtron në shitblerjen e tij!

Shohim një të mbuluar, që ndjek me përpikmëri ligjëratat e ndryshme javore, por është e paedukatë me nënën e saj!

Shohim një ndjekës të takimeve periodike të edukimit dhe udhëzimit fetar, por që shquhet për thashetheme dhe ndezjen e ngatërresave në mesin e njerëzve!

A është kjo feja? Jo, vëllezërit e mi!

Origjina e dërgesës së profetit të nderuar dhe qëllimi i saj përmbledhet në thënien e tij (a.s): “Jam dërguar të plotësoj vlerat e mirësjelljes!”

Dr. Salahudin A. Keftaro
Damask, Siri

“SABAHËT E RESULULL-LLAHUT (A.S), SHEMBULL BESIMI DHE PËRKUSHTIMI”, LIGJËRATA ME DOBI PËR BESIMTARËT

Të martën më 19 shkurt 2019, pas namazit të akshamit, në xhaminë e Perashit, Myftinia Shkodër organizoi aktivitetin e radhës me temë: “Sabahët e Resulull-llahut (a.s), shembull besimi dhe përkushtimi”.

Krahas xhematit të kësaj xhamie, merrnin pjesë edhe besimtarë të xhamive të tjera të qytetit, përfaqësues të Myftinisë Shkodër, drejtori i medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, z. Kujtim Dervishi, etj.

Në emër të Myftinisë Shkodër, këtë aktivitet të dobishëm e përshëndeti teologu Arben Halluni, i cili ndër të tjera tha, se kjo tribunë fetare vjen në vazhdim të një sërë aktivitetesh, që po zhvillohen në xhamitë të ndryshme të qytetit dhe jo vetëm, me tema të larmishme, me qëllim për të kujtuar vazhdimisht mesazhet dhe mësimet islame, të cilat e gjallërojnë shpirtin e besimtarit dhe bëjnë atë më të përkushtuar.

Më pas, dy imamët e nderuar, Naim Driaj, imam i xhamisë Parrucë dhe Adem Pizga, imam i xhamisë Perash, ligjëruan mbi temën: “Sabahët e Resulull-llahut (a.s), shembull besimi dhe përkushtimi”.

Imamët e nderuar sollën ngjarje dhe



shembuj konkretë nga jeta dhe vepra e ndritur e sahabëve të Pejgamberit (a.s), duke u ndalur në disa stacione me rëndësi, ku veçojmë: shembulli i sahabëve në marrëdhënie me besimin, përkushtimi i tyre në jetë dhe mundësitë e leximit të kësaj shembulltyre në ditët e sotme, dashuria e tyre për të dërguarin e All-llahut dhe dëshmimi i kësaj dashurie në jetën e përditshme, dëshmitë e tyre mbi mrekullitë e ndryshme të Pejgamberit (a.s.), vlera e tyre për mbarë ymetin islam në raport me transmetimet e shumta të fjalëve dhe traditave të Hz. Muhammedit (a.s.), etj.

Pas tubimit në xhaminë e Tophanës, në xhaminë e “Dy Vajzave” dhe në xhaminë e Perashit, Myftinia Shkodër ka planifikuar edhe të tjera tubime fetare me vlerë për besimtarët.

HIDHEN THEMELET PËR MINAREN E XHAMISË NË MILAN-RRASEK



Ditën e xhuma, më 22 shkurt 2019, pas namazit të xhumasë në xhaminë e lagjes Milan-Rrasek të fshatit Domën, u zhvillua ceremonia për hedhjen e gurit të themelit për minaren e re të kësaj xhamie.

I pranishëm ishte edhe Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, Kryetari i Njësisë Administrative

Postribë, z. Altin Shabaj, imamë e besimtarë të zonës, që e kanë pritur me shumë gëzim këtë ditë të bekuar.

Pas hytbes së xhumasë, ku solli në vëmendje të besimtarëve se, shpërblimi i bamirësisë dhe përkujdesjes për xhamitë dhe mësimet e besimit, kanë bekimin e All-llahut dhe mirësitë e Tij në të dy jetët, Myftiu shprehu falënderimet dhe mirënjohjen e tij për kontributet e atyre burrave të nderuar të Postribës dhe përtej saj, që përherë kanë dëshmuar shpirtin e besimit dhe besnikërinë ndaj fesë islame, brez pas brezi.

Duke hedhur gurin e themelit, Myftiu, së bashku me dhuruesin e tokës për xhaminë e Milanit, z. Sait Milani dhe z. Altin Shabaj, u lut për mbarësinë e punimeve dhe lehtësinë e tyre, me shpresën që minareja e kësaj xhamie të ketë përfunduar deri në ditën e Fitër Bajramit.

PËRFUNDON RESTAURIMI I XHAMISË SË FSHATIT GURI I ZI

Ditën e xhuma, më 22 shkurt 2019 u bë ceremonia e përfundimit të rikonstruksionit të xhamisë së fshatit Gur i Zi, Shkodër, financuar nga shoqata kuvajtiane “Duart e Bamirësisë”.

Në këtë ceremoni merrnin pjesë përfaqësues nga Myftinia Shkodër, të shoqatës “Duart e Bamirësisë”, imami i xhamisë, Ridvan Fregjaj, besimtarë etj.

Në emër të Myftinisë, përshëndeti teologu Arben Halluni, i cili falënderoi



donatorët për kontributin e vyer në rikonstruksionin e xhamisë, brenda dhe jashtë saj, si dhe për të gjitha ndihmat dhe kontributet që shoqata e institucione të ndryshme të Shtetit të Kuvajtit, që operojnë në Shqipëri, kanë dhënë e japin pa ndërprerje që nga viti 1991 e deri më sot.

Ndërsa, në emër të shoqatës “Duart e Bamirësisë” përshëndeti z. Ibrahim Mekki, i cili u shpreh, se institucioni që ai shërben nuk do të ndalet në zbatimin e projekteve të ndryshme si: rikonstruksion e ndërtim të xhamive të reja, ndihma për jetimet dhe për shtresat në nevojë, dhe shumë projekte të tjera kulturore dhe sociale.



“FJALA E MIRË ËSHTË SADEKA”, LIGJËRATA NGA XHAMIA E DËRGUTIT



Ditën e mërkurë, më 27 shkurt 2019, pas namazit të akshamit në xhaminë e lagjes Dërgut, Myftinia Shkodër organizoi një aktivitet me temë: “Fjala e mirë është sadeka”, ku ligjëruan imamët e nderuar Ervil Kuçi dhe Gilman Kazazi.

Në fjalët e tyre, imamët hodhën dritë mbi respektimin e fjalës në fenë islame, për vlerën e fjalës së urtë dhe të matur, si dhe dobritë e saj në këtë botë dhe në jetën e përtejme.

Në ligjëratën e tij, teologu Ervil Kuçi, imam i xhamisë së Dërgutit, shpjegoi hadithin: “Fjala e mirë është sadeka”, ku u ndal te kuptimet e sadekasë dhe vlerën që ka përzgjedhja e fjalëve në jetë.

Ai tha se, muslimani ndërton me fjalë, nuk vret me të, as fyen, as rëndon, as mbjell fitne, as mashtron, as gënjen! Njëkohësisht theksoi se, fjala e mirë, si: dhënia e selamit, këshillimi, mbështetja e nevojtarit, etj., janë vlera qytetëruese, me të cilat muslimanët janë spikatur gjatë historisë.

Ndërsa teologu Gilman Kazazi, imam i xhamisë “Ebu Bekër”, foli me hollësi për ajetet kur’anore që na ftojnë drejt përmirësimit të gjuhës së komunikimit me të tjerët në jetë; muslimanë qofshin, a jo.

Imami i nderuar solli shembuj të shumtë dhe me vlerë nga jeta e të parëve, prej hoxhallarëve e dijetarëve të shkuar, në gjurmët e të cilëve gjejmë shembuj konkretë të trupëzimit të vlerave islame.

Ndër të tjera, ai nxiti mirëpërdorimin e fjalës, përzgjedhjen e saj dhe moslëndimin e të tjerëve, qoftë edhe kur i drejtohem për t’i shprehur një të vërtetë të hidhur.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari. Ai solli në vëmendje të besimtarëve të pranishëm realitetin e shoqërisë së sotme shqiptare, si dhe përhapjen e fjalëve të ulëta dhe aspak të këndshme edhe në komunikimin e përditshëm të rinisë.

Myftiu solli disa shembuj konkretë nga ngjarje të jetuara, sikurse iu referua edhe një shkrimi të Lumo Skëndos, botuar në revistën “Zani i Naltë” në vitin 1926, në të cilin bën thirrje për ruajtjen nga devijimi në të folur dhe mosbastardhimi i gjuhës së përditshme me fjalë të ulëta, sharje e fyerje.

Në fund, teologu Lavdrim Hamja, pasi falënderoi ligjëruarit dhe të pranishmit, lajmëroi se takimi i radhës do të jetë ditën e martë, më 5 mars 2019, pas namazit të akshamit në xhaminë e lagjes Dudas.



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“Po i posedove katër

veçori, mos u dëshpëro

për çfarë mund të kesh

humbur nga kjo jetë:

Singeriteti i fjalës,

ruajtja e amanetit,

*mirësjellja dhe ruajtja
nga ushqimi haram!”*

*(Transmetuar nga Ahmedii,
Tabaraniu, Hakimi dhe Bejhekiu,
nga Ibn Omeri)*



MEJTEPI I IM... XHAMIA E FSHATIT DRISHT

PAK HISTORI:

- Xhamia Drisht, ndodhet në njësinë administrative Postrribë, zona Shkodër.

- Përbëhet me rreth 100 familje. Fiset më të njohura janë: Ara, Shkëmbi, Dushaj, Hamja, Curri, Tyrbetari, Bregu, Rrahi, Bahçja, etj.

- Pas rilejimit të besimit islam në vendin tonë, xhamia e vjetër Drisht ka qenë ndër të parat xhami në Shkodër që është hapur, në vitin 1992.

- Në këtë xhami nga viti 1992 deri më sot kanë shërbyer imam dhe mësues të mejtepeve si: Fadil Kraja (imam dhe mësues), Lavdrim Hamja (imam dhe mësues), Xhuljeta Hamja (mësuese), Xhavit Sokoli (imam aktual dhe mësues),



Ridvan Fregjaj (mësues aktual) dhe Esmerilda Kasemi (mësuese aktuale).

- Numri i nxënësve që kanë frekuentuar afërsisht 12 kurse të ndryshme fetare të mësim-besimit, të zhvilluar në xhami nga viti 1992 -2019 është rreth 170 nxënës dhe nxënëse.

TAKIMI ME NXËNËSIT:

Në kuadrin e vizitave dhe takimeve të sektorit të arsimit, pranë Myftinisë Shkodër me nxënësit e xhamive që frekuentojnë kurset-mejtepë e mësim-besimit, drejtuesi i tij, teologu Arben Halluni zhvilloi më 12 shkurt 2019 një takim me nxënësit e kurseve fetare në

xhaminë Drisht.

Ai u mbajti një bisedë , duke u përqendruar në rëndësinë dhe vlerën që ka organizimi i mejtepeve fetare pranë xhamive dhe për misionin që mbartin ato, pikërisht përçimin te brezi i ri mësimet e vërteta fetare, edukatën islame që duhet të ketë çdo besimtar dhe frymën e mirë paqësore dhe harmoninë që duhet të karakterizojë çdo njeri në marrëdhëniet me të gjithë njerëzit.

Në vijimësi të takimit, drejtuesi arsimit evidentoi ecurinë mësimore të nxënësve, pjesëmarrjen e tyre, procesin mësimor nga mësuesi Ridvan Fregjaj, i cili shërben me pasion dhe përkushtim për mirëmbajtjen e këtyre aktiviteteve mjaft të rëndësishme arsimore dhe edukative.



*“Pa shih me gafë përkulur kush po qan?
E drejta për të jetuar, e jetja, o musliman!
Shpëtoje atë të pashpresë për hir të Zotit,
Nga gjumërat e vdekjes zgjohu, pra!”*

Mehmet Akif Ersoj
(1873 – 1936)

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org